

URDHËR
Nr. 3762, datë 18.7.2016

**PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË SË
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**

(Ndryshuar me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

(i përditësuar)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 13, datë 8.6.2016, të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave me ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
4. Ky urdhër hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, urdhri nr. 1827, datë 16.3.2008, për miratimin e rregullore “Për kompensimin e depozitave”, shfuqizohet.

GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR KOMPENSIMIN E DEPOZITAVE TË SIGURUARA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

- a) rregullave të përgjithshme në lidhje me fazat, mënyrat dhe afatet për kompensimin e depozitave të siguruara;
- b) rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave dhe shërbimeve nga Agjencia për të përmbushur funksionet e saj në rast të kompen-simit të depozitave;
- c) marrëdhënieve ndërmjet subjekteve pjesë-marrëse në procesin e kompensimit të depozitave.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje dhe zbatim të neneve 1, pika 2, neneve 11, 38, 39, 40, 41, 42, pika 7, 44, pika 2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, si dhe të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe SHKK-të, likuidatori, subjektet në likuidim të detyruar, bankat agjente dhe subjektet mbështetëse të kontraktuara nga Agjencia për kryerjen e procesit të kompensimit.

Neni 4

Përkufizimi i termave

(Nryshuar shkronja ç) dhe d) e pikës 2 me vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim me përcaktimet e ligjit “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.

2. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë kuptim si vijon:

a) Bankë agjente është banka anëtare e skemës së sigurimit të depozitave, e cila përzgjidhet nga Këshilli Drejtues i Agjencisë për kryerjen e procesit të kompensimit, në emër dhe për llogari të Agjencisë si agjent pagese.

b) Subjekt në likuidim të detyruar është subjekti, i cili i nënshtrohet procesit të likuidimit të detyruar sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për shoqëritë e kursim kreditit”.

c) Subjekt mbështetës është individ, personi fizik tregtar apo juridik, i cili përzgjidhet nga Agjencia për kryerjen e shërbimeve dhe ofrimin e mallrave për përgatitjen dhe zbatimin e procesit të kompensimit.

ç) Paraqitja unike e depozituesve “Single Customer View” janë të dhënat e konsoliduara për identifikimin e çdo depozituesi në mënyrë unike në sistemin informatik të subjektit anëtar të skemës, nëpërmjet të dhënave të tij identifikuese, ku përcaktohen saktë depozitat e sigurueshme, si dhe shuma e kompensimit që përfiton ky depozitues.

d) Listëpagesa është dokumenti i dorëzuar nga likuidatori, që përmban paraqitjen unike të depozituesve që përfitojnë kompensim, si dhe shumat përkatëse për kompensim, dhe që pas kontrollit nga Agjencia, i dërgohet bankës agjente ose subjektit në likuidim të detyruar, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit.

dh) Detyrimet e papaguara në kohë janë detyrimet e depozituesve kundrejt subjektit anëtar të skemës, të përlogaritura nga dita e nesërme e datës së maturimit të tyre.

e) Përfaqësuesi i depozituesit është personi i autorizuar me prokurë ose nga ligji, trashëgimtari i depozituesit, ose çdo individ tjetër, që në bazë të tagrave ligjore paraqitet për të përfituar kompensimin e depozitës.

ë) Simulim është procesi i testimit të aftësisë të Agjencisë, të subjekteve të skemës të sigurimit të depozitave dhe të subjekteve mbështetëse për kryerjen e procesit të kompensimit.

f) “Sistemi informatik për raportim dhe kompensim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” ka të njëjtin kuptim me termin e përkufizuar në pikën 4, të nenit 26, të ligjit “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, dhe këtu e në vijim do të referohet si “SIRK”.

3) Titujt dhe krerët në këtë rregullore janë përdorur vetëm për orientim e referim dhe nuk kanë për qëllim të kushtëzojnë ose të kufizojnë interpretimin e përcaktimeve dhe të dispozitave të kësaj rregulloreje.

4. Në këtë rregullore, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjellas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përmbajtja e dispozitës.

5. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjellas.

KREU II

PËRGATITJA PËR KOMPENSIM GJATË VEPRIMTARISË SË PËRDITSHME

Neni 5

Burimet njerëzore

1. Agjencia ka të drejtë të punësojë personel shtesë, me kontratë me afat, pa procedurë konkurrimi, të cilët mund të jenë punonjës të Autoritetit Mbikëqyrës, të bankës agjente, specialistë nga institucionet homologe, si dhe ekspertë ndërkombëtarë.

2. Agjencia kryen trajnime të vazhdueshme të burimeve njerëzore të saj, bankës agjente, si dhe subjekteve mbështetëse, për zbatimin e saktë dhe në kohë të procesit të kompensimit.

Neni 6

Teknologjia e informacionit

(Shtuar pika 4 me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Agjencia krijon, përshtat dhe mirëmban SIRK me qëllim kompensimin e shpejtë dhe të saktë të depozitave.
2. Subjektet anëtare të skemës plotësojnë kushtet për listë pagesën me paraqitjen unike të depozituesit “Single Customer View”, sipas formatit standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe marrin pjesë në simulime për këtë qëllim.
3. Subjektet anëtare raportojnë paraqitjen unike të depozituesit “Single Customer View” brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e Agjencisë.
4. Listëpagesa është dokumenti i dorëzuar nga likuidatori, që përmban paraqitjen unike të depozituesve që përfitojnë kompensim, si dhe shumat përkatëse për kompensim, dhe që pas kontrollit nga Agjencia, i dërgohet bankës agente ose subjektit në likuidim të detyruar, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit.

Neni 7

Mjaftueshmëria e mjeteve financiare

1. Agjencia harton strategjinë për sigurimin e mjeteve likuide të nevojshme sipas subjektit anëtar përkatës dhe kryen analizën për kostot e procesit të kompensimit, si dhe të mënyrave të kryerjes së tij.
2. Strategjia për sigurimin e mjeteve likuide të nevojshme është subjekt simulimi.

Neni 8

Informimi i publikut dhe komunikimi me depozituesit

1. Agjencia harton strategjinë për informimin e publikut dhe komunikimin me depozituesit.
2. Autoriteti Mbikëqyrës dhe Agjencia krijojnë strategji të përbashkëta komunikimi për skenarë të ndryshëm të ngjarjeve të sigurimit.
3. Strategjitë e komunikimit, janë subjekt i simulimeve të përbashkëta midis Autoritetit Mbikëqyrës dhe Agjencisë.

Neni 9

Përzgjedhja e bankës agente dhe subjekteve mbështetëse

1. Agjencia kryen procedurat e përzgjedhjes të bankës agente dhe subjekteve mbështetëse në përputhje me kreun IV të kësaj rregulloreje, si dhe kryen simulime me to për përmbushjen e funksioneve të tyre gjatë procesit të kompensimit.
2. Subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave i raportojnë Agjencisë me kërkesë të saj, kontratat që ato kanë me operatorë të ndryshëm, që ofrojnë shërbime mbështetëse.

Neni 10

Verifikime në subjektet anëtare të skemës

(Shfuqizuar shkronja c) me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

Agjencia verifikon në subjektet anëtare:

- a) mbajtjen e të dhënave për depozitat dhe depozituesit në subjektin anëtar të skemës;
- b) nxjerrjen e listëpagesës me paraqitjen unike të depozituesve “Single Customer View”;
- c) Shfuqizuar.

Neni 11

Bashkëveprimi i Autoritetit Mbikëqyrës me Agjencinë

1. Autoriteti Mbikëqyrës informon Agjencinë, në rast të rrethanave që mund të shkaktojnë ngjarje sigurimi me qëllim marrjen e masave përgatitore për kryerjen e kompensimit të depozitave brenda një afati të arsyeshëm.
2. Autoriteti Mbikëqyrës, ndër të tjera:
 - a) fton punonjës të Agjencisë, në rast të kryerjes së inspektimeve në subjekt;
 - b) siguron pjesëmarrjen e Agjencisë në grupet e punës të ngritura në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij

neni;

c) konsultohet me Agjencinë për kryerjen e vlerësimit të kostove së kompensimit të depozitave për të përcaktuar domosdoshmërinë e kryerjes së kompensimit nëpërmjet pagesës së depozitave apo transferimit të mjeteve financiare të Agjencisë;

ç) i jep Agjencisë të dhëna mbi gjendjen financiare të bankave me qëllim përzgjedhjen e bankës agjente;

d) shqyrton për miratim brenda 7 ditëve, propozimin e Agjencisë për mbledhjen e primit përpara afatit, rritjen e tij dhe mbledhjen e kontributit të jashtëzakonshëm.

KREU III PROCESI I KOMPENSIMIT

Neni 12

Fazat e procesit të kompensimit

1. Procesi i kompensimit realizohet nëpërmjet tri fazave:

a) përgatitjet paraprake për kompensimin e depozitave;

b) kryerja e pagesave të kompensimit të depozitave; dhe

c) mbyllja e procesit të kompensimit.

2. Agjencia miraton akte të brendshme për organizimin e punës në Agjenci për kompensim.

Neni 13

Përgatitjet paraprake për kompensimin e depozitave

(Ndryshuar pika 3 me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Këshilli Drejtues i Agjencisë autorizon drejtorin e përgjithshëm për kryerjen e procedurave të përgatitjes për kompensimin e depozitave, me marrjen e informacionit nga Autoriteti Mbikëqyrës sipas nenit 11, pika 1, të kësaj rregulloreje, ose në çdo rast tjetër kur e gjykon të arsyeshme nisur nga kushtet e tregut.

2. Kjo fazë zgjat deri në momentin kur nis kryerja e pagesave të kompensimit.

3. Drejtori i përgjithshëm, me marrjen e autorizimit nga Këshilli Drejtues, organizon punën e strukturave të Agjencisë për zbatimin e masave vijuese për përgatitjen paraprake për kompensim, por pa u kufizuar, për:

a) verifikimin e të dhënave për depozitat dhe depozituesit në subjektin anëtar të skemës;

b) raportimin në SIRK nga subjekti anëtar i skemës, për paraqitjen unike të depozituesve “Single Customer View”, sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë;

c) propozimin për rishikimin e strategjisë për sigurimin e mjeteve likuide dhe fondeve shtesë të nevojshme sipas subjektit përkatës në likuidim të detyruar, me synim optimizimin e kostove dhe respektimin e afateve ligjore të kompensimit;

ç) kryerjen e analizës për kostot e procesit të kompensimit, si dhe të mënyrave të kryerjes së tij në zbatim të nenit 14, pika 4 të kësaj rregulloreje;

d) propozimin për rishikimin e strategjisë për informimin e publikut;

dh) vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe teknike nga bankat agjente dhe marrjen e ofertave ekonomike për caktimin e bankës agjente;

e) marrjen e ofertave ekonomike nga subjektet mbështetëse;

ë) analizimin e mjaftueshmërisë së burimeve njerëzore dhe marrjen e masave për plotësimin dhe trajnimin e tyre;

f) bashkëpunimin me Autoritetin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Financave për zbatimin e procesit të kompensimit;

g) propozimin për rishikimin e kuadrit rregullativ dhe rishikimin e akteve të brendshme, në rast se konsiderohet e nevojshme.

Neni 14

Kompensimi i depozitave

(Ndryshuar me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Me marrjen e njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit në likuidim të detyruar, Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton aktet e brendshme për kompensimin e depozitave, sipas propozimit të drejtorit të përgjithshëm, në veçanti për:

- a) përzgjedhjen e bankës agente dhe të mënyrës së kryerjes së pagesave të kompensimit;
 - b) miratimin e buxhetit për kompensim;
 - c) miratimin e strategjisë për sigurimin e mjeteve likuide dhe fondeve shtesë të nevojshme sipas subjektit përkatës në likuidim të detyruar;
 - ç) miratimin e strategjisë për informimin e publikut.
2. Drejtori i përgjithshëm, organizon punën e strukturave të Agjencisë për procesin e kompensimit.
3. Agjencia brenda 14 ditëve pune nga marrja e njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni, fillon kryerjen e pagesave të kompensimit të depozitave, nëpërmjet bankës agente ose në ambientet e subjektit në likuidim të detyruar në bashkëpunim me likuidatorin, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit.
4. Për depozituesit tregtarë dhe shoqëritë tregtare, pagesa e shumës së kompensimit kryhet nëpërmjet transfertës bankare. Për depozituesit individë, pagesa mund të kryhet edhe me para në dorë (CASH).

Neni 15

Dërgimi i listëpagesës

(Ndryshuar me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Likuidatori dërgon në Agjenci listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesve “Single Customer View” duke respektuar afatin e përcaktuar në nenin 39, pika 6 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar. Dërgimi i listëpagesës në Agjenci kryhet nëpërmjet ngarkimit të të dhënave në SIRK, sipas formatit standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.
2. Listëpagesa, sipas pikës 1 të këtij neni, përmban vlerën neto të depozitave që kompensohen deri në nivelin maksimal të mbulimit, pasi janë zbritur të gjitha detyrimet sipas ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, përfshirë ato tatimore të pagueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ngarkimi i listëpagesës zyrtare në SIRK shoqërohet me dërgimin e shkresës sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2 të kësaj rregulloreje, jo më vonë se 5 ditë nga vendosja e subjektit në likuidim të detyruar. Kjo shkresë nënshkruhet nga likuidatori dhe personat përgjegjës të ngarkuar për hartimin e listëpagesës.
4. Agjencia kontrollon të dhënat e listëpagesës të ngarkuara në SIRK, sipas akteve të miratuara prej saj për këtë qëllim. Të dhënat e listëpagesës, që kontrollohen nga Agjencia, klasifikohen në tri grupe:
 - a) të dhëna tërësisht të përputhshme dhe të gatshme për pagesë;
 - b) të dhëna pjesërisht të përputhshme dhe të dyshuara;
 - c) të dhëna të pasakta dhe të bllokuara.
5. Të dhënat e vlerësuara si tërësisht të përputhshme dhe të gatshme për pagesë, miratohen nga strukturat përkatëse të Agjencisë, sipas akteve të miratuara në zbatim të pikës 4 të këtij neni, dhe përfshihen në një listëpagesë, të konsoliduar për çdo depozitues.
6. Listëpagesa e saktë dhe e konsoliduar për kompensimin e depozituesve të siguruar, aksesohet në SIRK nga përdoruesit e autorizuar të Bankës Agente ose subjektit në likuidim të detyruar, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit. Agjencia i dërgon bankës agente ose subjektit në likuidim të detyruar, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit, informacionin e konsoliduar të listëpagesës me shkresë zyrtare.
7. Pjesa e mbetur e të dhënave i kthehen likuidatorit nëpërmjet SIRK-ut për saktësime përkatëse.
8. Likuidatori korrigjon të dhënat e pasakta, të paplota, të rreme apo të falsifikuara dhe i raporton ato në të njëjtën mënyrë sipas përcaktimeve të këtij neni dhe afatit të përcaktuar nga Agjencia, duke i shoqëruar edhe me shkresë zyrtare.

Neni 16

Bashkëpunimi me likuidatorin

(Ndryshuar me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Likuidatori bashkëpunon me Agjencinë, në veçanti, por pa u kufizuar në lidhje me:
 - a) përgatitjen dhe dërgimin e listëpagesës, duke raportuar në SIRK, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje;
 - b) shqyrtimin e ankesave të depozituesve në përputhje me nenin 20 të kësaj rregulloreje;
 - c) trajnimin e punonjësve të subjektit në likuidim të detyruar për informimin e depozituesve lidhur me kompensimin e depozitave;

d) mbrojtjes të interesave të Agjencisë për rimarrjen e shpenzimeve dhe të shumave të paguara prej saj nga procesi i likuidimit.

2. Likuidatori i dërgon Agjencisë informacionin e parashikuar në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, si dhe çdo informacion të kërkuar prej saj, në veçanti në lidhje me:

a) pasqyrat kontabël dhe statistikore për veprimet me depozitat gjatë tre muajve të fundit përpara vendosjes së subjektit në likuidim të detyruar;

b) të dhëna mbi mashtimet me depozitat, apo depozitat e përdorura për qëllime të pastrimit të parasë ose financimit të terrorizmit;

3. Në rastet kur konstatohet se kompensimi është kryer mbi të dhëna të pavërteta dhe të pasakta në listëpagesën e dërguar nga likuidatori, ky i fundit i rimbursion Agjencisë shumën e kompensuar gabimisht.

4. Agjencia informon likuidatorin për depozituesit dhe shumën e kompensuar sipas listëpagesës.

5. Në rastin kur procesi i kompensimit kryhet në ambientet e subjektit të vendosur në likuidim të detyruar, likuidatori bashkëpunon me Agjencinë për kryerjen e pagesave të kompensimit.

Neni 17

Marrëdhënia me bankën agjente

(Ndryshuar me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Drejtori i përgjithshëm nënshkruan autorizimin për kompensimin e depozitave, që i dërgohet bankës agjente, sipas kreut IV të kësaj rregulloreje.

2. Banka agjente kryen procesin e kompensimit, në emër dhe për llogari të Agjencisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara të nënshkruar me Agjencinë.

3. Banka agjente përdor modulet përkatëse në SIRK, si dhe akseson listëpagesën me të dhënat të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

4. Në raste të jashtëzakonshme të mosfunksionimit të SIRK-ut, Agjencia i dërgon bankës agjente listëpagesën me të dhënat të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje nëpërmjet mënyrave alternative të dakordësuara ndërmjet palëve.

5. Agjencia i transferon Bankës Agjente mjetet likuide për kompensimin e depozitave, si dhe paguan për ofrimin e këtij shërbimi sipas shumave të negociuara me të, përveç rastit kur ky shërbim ofrohet falas.

6. Banka agjente i raporton Agjencisë nëpërmjet SIRK-ut raporte periodike, sipas kërkesave të saj dhe në përputhje me kushtet edhe dokumentet tip të parashikuara në kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara të nënshkruar me Agjencinë, në veçanti për:

a) shumat dhe numrin e depozitueseve që kanë përfituar nga kompensimi;

b) shumat dhe numrin e depozitueseve që kanë mbetur për t'u kompensuar;

c) ankesat e depozituesve.

7. Banka agjente duhet të përfshijë në planin e vijimësisë së biznesit të saj, planin e veprimit për kryerjen e procesit të kompensimit.

8. Për çështje që nuk janë rregulluar shprehimisht në këtë rregullore dhe në kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara të nënshkruar me Agjencinë, palët veprojnë në përputhje me ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 18

Informimi i publikut dhe komunikimi me depozituesit

1. Agjencia informon publikun dhe komuni-kon me depozituesit për fillimin, ecurinë dhe përfundimin e procesit të kompensimit.

2. Mënyrat e informimit dhe komunikimit janë, por pa u kufizuar:

a) konferenca për shtyp;

b) publikime, komunikime në media;

c) njoftime në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë;

ç) komunikime nëpërmjet linjave telefonike falas dhe pa pagesë dhe qendrave telefonike;

d) komunikime nëpërmjet profileve elektro-nike të Agjencisë në rrjetet sociale.

Neni 19

Procedurat e pagesës

(Ndryshuar me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Depozituesi, për të përfituar kompensimin e depozitës, paraqet dokumentacionin identifikues sipas aneksit 3 të kësaj rregulloreje.

2. Procedura e pagesës së shumës së kompensimit kryhet në përputhje me aneksin 3 të kësaj rregulloreje dhe kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruar të nënshkruar me Agjencinë.

3. Banka agjente kryen pagesën e kompensimit vetëm për depozituesit e përfshirë në listëpagesën e depozituesve që përfitojnë kompensim nga skema e sigurimit të depozitave.

4. Banka agjente refuzon kryerjen e pagesës së kompensimit për depozituesit, kur:

- a) ka mospërputhje të të dhënave në listëpagesë me dokumentacionin e paraqitur nga depozituesi;
- b) depozituesi nuk është dakord me shumën e kompensimit;
- c) depozituesi nuk është i përfshirë në listëpagesën e depozituesve.

Neni 20

Ankesat e depozituesve

(Ndryshuar me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Çdo depozitues, i subjektit të vendosur në likuidim të detyruar, mund të paraqesë ankesë pranë Agjencisë, ose bankës agjente, në rast refuzimi të pagesës së kompensimit nga banka agjente, sipas pikës 4 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, duke plotësuar dokumentet tip të miratuara nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë, dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

2. Ankesat për pagesat e kompensimit administrohen në përputhje me aktet e Agjencisë të miratuar për këtë qëllim.

3. Agjencia, banka agjente dhe likuidatori shkëmbejnë informacione për shqyrtimin e ankesave në modulën e ankesave në SIRK, nëpërmjet përdoruesve të autorizuar të këtij moduli.

4. Agjencia, shqyrton ankesat e depozituesve së bashku me dokumentacionin mbështetës të paraqitur prej tyre. Për verifikimin e dokumentacionit mbështetës të ankesave Agjencia bashkëpunon me likuidatorin. Likuidatori i jep Agjencisë të dhënat dhe dokumentacionin për ankesat, nëpërmjet SIRK-ut, brenda 10 ditësh nga kërkesa e Agjencisë. Në këtë rast, afati i shqyrtimit të ankesës ndërpritet dhe rifillon pasi likuidatori të ketë dorëzuar të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga Agjencia.

5. Likuidatori korrigjon të dhënat e listëpagesës, sipas vendimit të Agjencisë për ankesat dhe ia dërgon atë asaj në të njëjtën mënyrë sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje, brenda 3 ditësh nga marrja e njoftimit për vendimin e Agjencisë.

6. Në rast se për vlerësimin e ankesës gjykohet se duhet të paraqiten dokumente dhe fakte të tjera që vërtetojnë pretendimin për kompensimin e depozitës, ankimuesi i paraqet ato brenda 10 ditësh nga njoftimi i Agjencisë. Në këtë rast, afati i shqyrtimit të ankesës ndërpritet dhe rifillon pasi Agjencia të ketë siguruar të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga ankimuesi.

7. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Agjencia mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

8. Në rast se kompensimi i depozitave kryhet në subjektin e vendosur në likuidim të detyruar, likuidatori mban të dhëna të konsoliduara mbi ankesat e depozituesve të paraqitura tek ai dhe informon Agjencinë në lidhje me to sipas kërkesës së saj.

9. Çdo depozitues ka të drejtën të ankimojë vendimin e Agjencisë pranë Autoritetit Mbikëqyrës brenda afatit 30-ditor të përcaktuar në nenin 132 të Kodit të Procedurës Administrative.

Neni 21

Mbyllja e procesit të kompensimit

1. Në përfundim të afatit ligjor të kompensimit, Këshilli Drejtues i Agjencisë merr vendime për mbylljen e këtij procesi sipas akteve të brendshme të Agjencisë.

2. Këshilli Drejtues i Agjencisë analizon ecurinë e procesit të kompensimit nëpërmjet raportimeve të subjekteve të përfshira në të, si dhe miraton planin e masave për përmirësimin e këtij procesi.

3. Në përfundim të procesit të kompensimit Agjencia kryen njoftimin e depozituesve që nuk janë paraqitur brenda afatit të kompensimit.

Neni 21/1

Konfidencialiteti

(Shtuar me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

Anëtarët e Këshillit Drejtues, drejtori i përgjithshëm, punonjësit e Agjencisë, likuidatori, banka agjente, subjektet mbështetëse, si edhe personat e kontraktuar nga Agjencia, ruajnë konfidencialitetin e informacionit, që marrin si rezultat i kryerjes së detyrave, gjatë procesit të kompensimit.”

KREU IV

PËRZGJEDHJA E BANKAVE AGJENTE DHE SUBJEKTEVE MBËSHTETËSE¹

Neni 22

Fazat e përzgjedhjes së bankave agjente dhe subjekteve mbështetëse

(Ndryshuar fjalia e dytë e shkronjës a) të pikës 1, dhe fjalia e dytë e pikës 2 me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Në zbatim të nenit 42, pika 7, të ligjit për sigurimin e depozitave i ndryshuar, përzgjedhja e bankave agjente bëhet në dy faza:

a) Faza e parë - vlerësimi i bankave anëtare të skemës sipas kriterëve të përgjithshme dhe teknike dhe nënshkrimi i kontratave për kryerjen e kompensimit të depozitave me bankat e përzgjedhura në listën paraprake. Kjo fazë reali-zohet gjatë veprimtarisë së përditshme sipas kreut II të kësaj rregulloreje. Lista paraprake përbëhet nga bankat anëtare të cilat përmbushin kriteret e përgjithshme dhe marrin nga vlerësimi i kriterëve teknike pikët më të larta, sipas rendit zbritës, sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje.

b) Faza e dytë - vlerësimi i ofertave ekono-mike nga bankat e përzgjedhura në listën paraprake gjatë përgatitjes paraprake sipas nenit 12, pika 1, shkronja “a” të kësaj rregulloreje dhe dërgimi i autorizimeve për kryerjen e kompensimit të depozitave bankës agjente të shpallur fituese, pas njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit në likuidim të detyruar.

2. Në rast pamundësie për të kryer procedurat për përzgjedhjen e bankës agjente, Këshilli Drejtues i Agjencisë, me propozim të drejtorit të përgjithshëm, vendos për nënshkrimin e kontratës në mënyrë të drejtpërdrejtë me një bankë nga bankat anëtare të skemës. Në këtë rast, Këshilli Drejtues kërkon opinionin zyrtar të Autoritetit Mbikëqyrës për përzgjedhjen e bankës agjente në mënyrë të drejtpërdrejtë.

3. Në zbatim të nenit 42, pika 7, të ligjit për sigurimin e depozitave, i ndryshuar, përzgjedhja e subjekteve mbështetëse kryhet gjatë periudhës së përgatitjes për kompensim në veprimtarinë e përditshme sipas kreut II, si edhe në procesin e kompensimit sipas kreut III të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Kompetencat për përzgjedhjen e bankave agjente

(Hequr fjalia e fundit e pikës 3 dhe shtuar si pikë 4 me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Këshilli Drejtues i Agjencisë përzgjedh çdo tre vjet bankat agjente nga bankat anëtare të skemës për sigurimin e depozitave.

2. Këshilli Drejtues i Agjencisë krijon një komision të përhershëm vlerësimi për përzgjedhjen e bankave agjente. Në këtë vendim përcaktohet edhe kryetari i komisionit.

3. Komisioni i përhershëm i vlerësimit përbëhet nga 5 persona si vijon: një anëtar i Këshillit Drejtues të Agjencisë, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë, një përfaqësues i Autoritetit Mbikëqyrës dhe punonjës të Agjencisë. Në të mund të përfshihen edhe specialistë/ekspertë të fushës.

4. Autoriteti Mbikëqyrës, me kërkesë të komisionit të përhershëm të vlerësimit, paraqet opinionin zyrtar për gjendjen financiare të bankave anëtare të skemës, i cili përfshin të dhëna jo më të hershme se tre muaj nga data e zhvillimit të vlerësimit.

¹Vendimi nr.2680 datë 20.6.2024, botuar në F.Z. nr. 105, datë 26.6.2024, në kreun II të tij shprehet: “Procedura e përzgjedhjes së bankave agjente, në listën paraprake për periudhën 2024–2026, e nisur para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të vijojë të realizohet sipas kriterëve të kualifikimit të bankave agjente, të përcaktuara në rregulloren nr. 3762, datë 18.7.2016, “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, në fuqi, në momentin e fillimit të kësaj procedure.

Neni 24

Faza e parë - përzgjedhja e bankave në listën paraprake

(Ndryshuar pika 5 dhe shfuqizuar pika 6 me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Përzgjedhja e bankave anëtare në listën paraprake kryhet gjatë periudhës së përgatitjes për kompensim në veprimtarinë e përditshme sipas kreut II të kësaj rregulloreje. Kjo fazë fillon me dërgimin e ftesës bankave anëtare të skemës dhe përfundon me marrjen e vendimit nga Këshilli Drejtues i Agjencisë për përzgjedhjen e bankave në listën paraprake.

2. Këshilli Drejtues i Agjencisë autorizon Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit për fillimin e procedurave sipas këtij neni.

3. Drejtori i përgjithshëm nënshkruan ftesën që i dërgohet të gjithave bankave anëtare të skemës. Ftesat shoqërohen me kriteret e përgjithshme dhe teknike të kualifikimit, udhëzime, kushtet e kontratës për kryerjen e kompensimit të depozitave, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm.

4. Vlerësimi i bankave anëtare të skemës nga komisioni i përhershëm kryhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aneksin 4 të kësaj rregulloreje.

5. Këshilli Drejtues shqyrton raportin e komisionit të përhershëm të vlerësimit dhe merr vendim për nënshkrimin e kontratës për kryerjen e kompensimit të depozitave me bankat anëtare të cilat, vlerësohen se:

a) përmbushin kriteret e përgjithshme; dhe

b) marrin minimumin e pikëve për përmbushjen e kriterëve teknike, sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje.

6. Shfuqizuar.

7. Aktet e Këshillit Drejtues të Agjencisë për përzgjedhjen e bankave agjente janë përfundimtare dhe nuk mund të ankimohen.

Neni 25

Nënshkrimi i kontratave me bankat e përzgjedhura në listën paraprake

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 3 me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

1. Kontratat për kryerjen e kompensimit nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Këshillit Drejtues për përzgjedhjen e bankave në listën paraprake.

2. Afati i kontratave është 1-vjeçar (njëvjeçar) dhe me të drejtë rinovimi njëvjeçarë edhe për 2 (dy) vjet pasuese.

3. Drejtori i përgjithshëm miraton dhe nënshkruan kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet e ofrimit të shërbimit, si dhe dokumentet udhëzuese për kryerjen e tij.

4. Bankat e përzgjedhura në listën paraprake, me të cilat janë nënshkruar kontratat për kryerjen e kompensimit të depozitave, rivlerësohen çdo vit nga komisioni i përhershëm i vlerësimit për përputhshmërinë me kriteret e përgjithshme dhe teknike.

5. Kontrata konsiderohet e rinovuar edhe për 1 (një) vit, nëse banka me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe teknike.

6. Agjencia merr masa për përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake, 6 muaj përpara përfundimit të kontratave në fuqi me bankat e përzgjedhura në listë.

Neni 26

Faza e dytë – vlerësimi i ofertave ekonomike

Përzgjedhja e bankës agjente në ngjarjen e sigurimit

1. Përzgjedhja e bankës agjente nga lista paraprake kryhet kur Këshilli Drejtues i Agjencisë autorizon Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit për fillimin e procedurave sipas këtij neni. Në këtë vendim përcaktohet edhe fondi limit i pagesës së bankës agjente për shërbimin e ofruar, sipas propozimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit. Ky fond është i zbatueshëm nëse asnjë nga ofertat që do të paraqiten nga bankat e përzgjedhura nuk përfshin ofrimin e shërbimit falas.

2. Kjo fazë fillon me dërgimin e kërkesës për ofertë ekonomike bankave të përfshira në listën paraprake dhe përfundon me marrjen e vendimit nga Këshilli Drejtues i Agjencisë për përzgjedhjen e

bankës agjente fituese.

3. Komisioni i përhershëm i vlerësimit përpara marrjes së ofertave ekonomike, nëse e gjykon të arsyeshme, mund të verifikojë përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe teknike nga bankat e përfshira në listën paraprake sipas pikës 6, të nenit 24, të kësaj rregulloreje.

4. Drejtori i përgjithshëm nënshkruan kër-kesën për ofertë që i dërgohet bankave të përfshira në listën paraprake.

5. Komisioni i përhershëm i vlerësimit, nëse e gjykon të arsyeshme, kryen negociime me bankat për sqarimin dhe përmirësimin e kushteve të kontratës; të mënyrave të kalimit të mjeteve monetare të Agjencisë; të listës së degëve dhe pikave të pagesës të bankës; si dhe të metodologjisë së kryerjes të shërbimit dhe përbërjen e stafit, i cili do të marrë pjesë në procesin e kompensimit.

6. Bankat paraqesin ofertat ekonomike për shërbimin e kompensimit të depozitave brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e komisionit të përhershëm të vlerësimit.

7. Komisioni i përhershëm i vlerësimit i paraqet për shqyrtim Këshillit Drejtues raportin e vlerësimit, në të cilin klasifikohen sipas rendit zbritës ofertat e paraqitura. Banka që vlerësohet se ka paraqitur ofertën ekonomikisht më të favorshme sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje, renditet e para.

8. Këshilli Drejtues merr vendim për për-zgjedhjen e bankës agjente vetëm pasi njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit në likuidim të detyruar. Ky vendim përcakton mënyrën e pagesës së kompensimit, pagesën e bankës agjente (nëse ka), mënyrën e kalimit të mjeteve monetare të Agjencisë për kompensimin e depozitave etj.

9. Këshilli Drejtues kur e vlerëson të arsyeshme mund të përzgjedhë më shumë se një bankë agjente nga lista paraprake.

10. Bankës/ve agjente fituese i dërgohet autorizimi për kompensimin e depozitave, jo më vonë se dita e nesërme e punës nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues.

11. Vendimi i Këshillit Drejtues për për-zgjedhjen e bankës/ave agjente hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

12. Në rast se banka/at agjente fituese shkel kushtet e kontratës ose tërhiqet, Këshilli Drejtues i Agjencisë merr vendim për zëvendësimin e saj, duke përzgjedhur bankën agjente që renditet e dyta në vlerësimin përfundimtar.

Neni 27

Përzgjedhja e subjekteve mbështetëse

1. Subjekte mbështetëse që ofrojnë shërbime dhe mallra për përgatitjen dhe kompensimin e depozitave mund të jenë: shërbime për zhvillim dhe mirëmbajtje të SIRK-së dhe platforma të tjera elektronike; shërbime kontabiliteti dhe mbështetje për veprimet me listëpagesën e kompensimit, shërbime auditimi, shërbime ligjore; qendër thirrjesh telefonike (*call center*); shërbime konsulence profesionale; shërbime financiare; shërbime vlerësimi për rimarrje, shërbime ndërmjetësimi dhe pajtimi, shërbime të ruajtjes fizike.

2. Njësitë organizative të Agjencisë i paraqesin drejtorit të përgjithshëm propozimin për kontraktimin e subjekteve mbështetëse nëpër-mjet studimit të tregut mbi vlerat limit të kontratave, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kriteret e kualifikimit. Përcaktimi i fondit limit bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH në tregun vendas dhe nëse gjykohet e nevojshme në shumën e pagueshme nga skemat homologe të sigurimit të depozitave.

3. Drejtori i përgjithshëm, bazuar në propozimin e njësive organizative të Agjencisë, i kërkon Këshillit Drejtues dhënien e autorizimit për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e subjekteve mbështetëse. Vendimi i Këshillit Drejtues përcakton kategoritë e subjekteve mbështetëse për të cilat do të kryhen procedurat e përzgjedhjes dhe fondet limite përkatëse për çdo kontratë.

4. Këshilli Drejtues me propozim të drejtorit të përgjithshëm vendos për marrjen e shërbimeve dhe mallrave sipas pikës 1 të këtij neni, nga subjektet që janë ose kanë qenë të kontraktuara nga Agjencia, pa kryer procedurat e përzgjedhjes, kur gjykohet se përmbushja e detyrimeve prej tyre ka qenë e kënaqshme.

5. Subjektet që ofrojnë mallra dhe/ose shërbime të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni (mirëmbajtje, kancelari, transport, konferenca, karburant, shërbime postare, trajnime, akomodime stafi, tryeza të rrumbullakëta, linja telefonike pa pagesë, materiale informative dhe promocionale etj.), kontraktohen drejtpërdrejt me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, sipas propozimit të sektorit përkatës të Agjencisë, në procesin e kompensimit sipas kreut III të kësaj rregulloreje.

Vlerësimi i subjekteve mbështetëse

1. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë krijon një njësi vlerësimi të subjekteve mbështetëse të përcaktuara në pikën 1, të nenit 27, të kësaj rregulloreje, përveç për rastet në të cilat zbatohet pika 4, e nenit 27, të kësaj rregulloreje. Kjo njësi përbëhet nga 3 persona dhe mund të përbëhet nga punonjës të Agjencisë dhe/ose specialistë/ ekspertë të fushës.

2. Njësia e vlerësimit i dërgon ftesën për ofertë jo më shumë se 3 (tri) subjekteve mbështetëse të së njëjtës natyrë. Ftesat shoqë-rohen me kriteret e kualifikimit, udhëzimet, kushtet e kontratës, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm.

3. Vlerësimi i subjekteve mbështetëse nga njësia e vlerësimit kryhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aneksin 4 të kësaj rregulloreje.

4. Njësia e vlerësimit harton raportin në të cilin subjektet që përmbushin kriteret e kualifikimit klasifikohen sipas rendit zbritës të ofertave të paraqitura. Subjekti që ka ofruar çmimin më të ulët renditet i pari.

5. Drejtori i përgjithshëm shqyrton raportin e njësisë të vlerësimit dhe urdhëron nënshkrimin e kontratës me subjektin fitues për çdonjërin nga kategoritë.

6. Drejtori i përgjithshëm miraton dhe nënshkruan kontratën tip për kryerjen e shërbimeve dhe ofrimin e mallrave, nëse ka, me subjektet mbështetëse.

7. Urdhrat e drejtorit të përgjithshëm për përzgjedhjen e subjekteve janë përfundimtare dhe nuk mund të ankimohen.

Neni 29

Anulimi i procedurave të përzgjedhjes

1. Në përputhje me vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë ose urdhrit të drejtorit të përgjithshëm sipas kompetencave përkatëse, procedurat e përzgjedhjes anulohen në këto raste:

a) nëse brenda afatit të përcaktuar nuk janë paraqitur dokumentacione ose oferta nga bankat dhe/ose subjektet;

b) nëse mbi bazë të rezultateve të vlerësimit është marrë vendimi për refuzimin e të gjithë bankave dhe/ose subjekteve për shkak të mos-plotësimit të kriterëve.

2. Në rastet e anulimit të procedurave sipas pikës 1 të këtij neni, Këshilli Drejtues i Agjencisë ka të drejtë të vendosë, për:

a) ripërsëritjen e procedurave;

b) nënshkrimin e kontratave në mënyrë të drejtpërdrejtë me një bankë ose subjekt mbështetës të përcaktuar në pikën 1, të nenit 27.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Masat ndëshkimore

1. Agjencia, në rast shkeljeje të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve të miratuara prej saj nga likuidatori ose punonjësit e subjektit nën likuidim, i propozon Autoritetit Mbikëqyrës marrjen e masave ndëshkimore.

2. Agjencia, në rast shkeljeje të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve të miratuara prej saj nga subjektet mbështetëse, zbaton sanksionet e përcaktuara në kontratën e lidhur.

Neni 31

Plani i veprimit për kompensim

Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë miraton, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, planin e veprimit, i cili përmban dokumentet tip dhe procedurën e brendshme operacionale të Agjencisë për përgatitjen dhe kryerjen e kompensimit të depozitave.

Neni 32

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
2. Kjo rregullore shfuqizon rregulloren “Për kompensimin e depozitave” dhe udhëzimin “Për procedurat e kompensimit të depozitave të siguruara”, të miratuara me urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. prot. 1827, datë 6.3.2008.

ANEKSI 1
LISTËPAGESA
(Ndryshuar me me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

Për individët

Nr.	Përshkrimi	Koment
1	Kodi unik i depozituesit në bankë/SHKK	Sipas të dhënave në bankën/SHKK-në nën likuidim të detyruar
2	Emri	Emri
3	Atësia	Atësia
4	Mbiemri	Mbiemri
5	Mbiemri përpara martese	Mbiemri përpara martese
6	Gjinia	Gjinia
7	Rezidenca	01 – Rezident 02 – Jo rezident
8	Statusi i depozituesit	01 – I punësuar 02 – I papunësuar 03 – Student 04 – Pensionist 05 – Tjetër
9	Tipi i dokumentit të identifikimit	1 – Kartë identiteti 2 – Pasaportë 3 – Të tjera
10	Numri personal i identifikimit të depozituesit	Numri unik i identifikimit sipas dokumentit të identifikimit
11	Numri i dokumentit të identifikimit	Numri i dokumentit të identifikimit
12	Data e lëshimit të dokumentit të identifikimit	Data e lëshimit të dokumentit të identifikimit
13	Data e skadimit të dokumentit të identifikimit	Data e skadimit të dokumentit të identifikimit
14	Datëlindja	Datëlindja
15	Adresa	Adresa
16	Numri i telefonit	Numri i telefonit
17	E-mail	E-mail
18	Shtetësia	Shteti që ka lëshuar mjetin e identifikimit sipas kodit ISO
19	Shuma e kompensimit	Shuma totale për t’iu kompensuar depozituesit
20	Data e dërgimit të listëpagesës	Data e dërgimit të listëpagesës

Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

Nr.	Përshkrimi	Koment
1	Kodi unik i depozituesit në bankë/SHKK	Sipas të dhënave në bankën/SHKK-në nën likuidim të detyruar
2	Emri i subjektit	Emri i subjektit tregtar
3	Numri unik i identifikimit të subjektit	NUIS
4	Data e regjistrimit të subjektit	Sipas ekstraktit të QKB
5	Forma ligjore	Tregtarë, shoqëri aksionare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, Shoqëri kolektive, shoqëri komandite, të tjera
6	Adresa e selisë	Adresa
7	Numri i telefonit	Numri i telefonit
8	E-mail	E-mail
9	Shuma e kompensimit	Shuma totale për t’iu kompensuar subjektit
10	Data e dërgimit të listëpagesës	Data e dërgimit të listëpagesës

ANEKSI 2
SHKRESË PËR DËRGIMIN E LISTËPAGESËS
(Ndryshuar me me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

Me anë të kësaj shkrese deklarojmë se informacioni i raportuar në SIRK nëpërmjet ngarkimit të skedarëve sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, dhe të rregullores nr. 3762, datë 18.7.2016, “Për kompensimin e depozitave”, të ndryshuar.

Njësia që e përgatit informacionin dhe njësia që e monitoron këtë informacion sigurojnë vërtetësinë e regjistrimit të transaksioneve, dhe se informacioni i raportuar Agjencisë në SIRK në dijeninë më të mirë është i vërtetë dhe i saktë. Konfirmojmë se, sistemet e përpunimit të të dhënave të subjektit në likuidim të detyruar përputhen me kërkesat e Agjencisë.

Listëpagesa e depozituesve që kompensohen, e ngarkuar në SIRK, përmban në mënyrë të konsoliduar të dhënat e mëposhtme:

- a) totali i depozitave për t’u kompensuar është _____;
- b) numri i depozituesve për t’u kompensuar është _____.

Njësia që përgatiti informacionin
(emër, mbiemër, pozicion pune,
firmë, vulë)

Njësia monitoruese
(emër, mbiemër, pozicion pune,
firmë, vulë)

Likuidatori
(emër, mbiemër, pozicion pune,
firmë, vulë)

ANEKSI 3
PROCEDURA E PAGESËS SË SHUMËS SË KOMPENSIMIT
(Ndryshuar me me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

A. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR DEPOZITUESIT INDIVIDË

Pagesa e kompensimit kryhet si vijon:

1. Konfirmohet identiteti i depozituesit nëpërmjet verifikimit të **emrit, mbiemrit dhe numrit personal** sipas dokumenteve të identifikimit (pasaportë biometrike ose kartë identiteti), të cilat duhet të përputhen me të dhënat e listëpagesës.

2. Pas konfirmimit të identitetit të depozituesit, banka agjente, kryen veprimet nëpërmjet SIRK-ut, sipas manualit të përdorimit të tij, si dhe ngarkon në SIRK dokumentacionin përkatës, që vërteton kryerjen e pagesës, në përputhje me procedurën e përcaktuar nga Agjencia.

3. PAGESA E KOMPENSIMIT, kryhet me para në dorë (CASH), ose transfertë në një llogari, në njërën nga bankat, që operojnë në Shqipëri, sipas përcaktimeve në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

B. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR DEPOZITUESIT INDIVIDË ME PERSON TË AUTORIZUAR

1. Në rastin kur depozituesi përfaqësohet nga personi i autorizuar, banka agjente kryen edhe verifikimin e identitetit të personit të autorizuar. Personi i autorizuar paraqet prokurën origjinale, të posaçme për pagesën e kompensimit. Prokura e përfaqësuesit të depozituesit duhet të përmbajë të dhënat e dokumentit identifikues të depozituesit, të cilat duhet të përputhen me të dhënat e listëpagesës.

2. Prokurat e hartuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë të legalizuara me vulën *Apostille*, e lëshuar nga autoriteti përkatës kompetent i vendit ku është lëshuar prokura. Për ato shtete, të cilat nuk janë palë në Konventën e Hagës, prokura duhet të jetë e legalizuar nga autoriteti përkatës kompetent i vendit, ku është lëshuar prokura. Dokumentacioni në çdo rast, duhet të shoqërohet me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

3. Pas konfirmimit të identitetit të personit të autorizuar, banka agjente kryen veprimet sipas përcaktimit në shkronjën “A”, pika 2 të këtij aneksi.

4. Pagesa e kompensimit kryhet me para në dorë (*CASH*) ose transfertë në një llogari në njërën nga bankat, që operojnë në Shqipëri, sipas përcaktimeve në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

A. Pagesa e kompensimit për depozituesit e mitur

1. Në rastin kur depozituesi është i mitur, banka agjente kryen edhe verifikimin e identitetit të përfaqësuesit ligjor të të miturit, i cili mund të jenë prindi ose kujdestari ligjor.

2. Dokumentet që paraqiten nga përfaqësuesi ligjor i të miturit janë:

- a) certifikatë personale/pasaportë e të miturit;
- b) certifikatë familjare e të miturit;
- c) vendimi i kujdestarisë sipas rastit;
- ç) dokumenti identifikues i përfaqësuesit ligjor të të miturit.

3. Pagesa e kompensimit bëhet nëpërmjet transfertës në një llogari bankare, në lek, në emër të të miturit, në njërën nga bankat, që operojnë në Shqipëri. Përfaqësuesi ligjor që jep numrin e llogarisë bankare duhet të sigurohet që ajo të ketë statusin aktiv.

Ç. Pagesa e kompensimit për depozituesit me zotësi të kufizuara për të vepruar ose pa zotësi për të vepruar

1. Në rastin kur depozituesi është person me zotësi të kufizuara ose nuk ka zotësi për të vepruar, banka agjente kryen edhe verifikimin e identitetit të përfaqësuesit ligjor të tij.

2. Dokumentet që paraqiten nga përfaqësuesi ligjor i këtij depozituesi janë:

a) dokument identifikimi i personit me zotësi të kufizuara për të vepruar ose pa zotësi për të vepruar;

b) dokument identifikimi i përfaqësuesit ligjor;

c) vendimin e institucionit që përcakton përfaqësuesin ligjor, sipas rastit.

3. Pagesa e kompensimit bëhet nëpërmjet transfertës në një llogari bankare, në lek, në emër të këtij depozituesi, në njërën nga bankat, që operojnë në Shqipëri. Personat që japin numrin e llogarisë bankare duhet të sigurohen që ajo të ketë statusin aktiv.

B. Pagesa e kompensimit për trashëgimtarët

1. Pagesa e shumës për kompensim për trashëgimtarët e depozituesit kryhet vetëm nëse paraqitet akti për ndarjen e trashëgimisë sipas ligjeve në fuqi. Në këtë rast, banka agjente kryen edhe verifikimin e identitetit të trashëgimtarëve.

2. Në rastet kur titullari me të drejta të plota i depozitës ka vdekur (*mortis causa*), dhe ky fakt nuk ishte i njohur për likuidatorin në kohën e përgatitjes së listëpagesës, banka agjente nuk kryen pagesën, por informon Agjencinë për rastin në fjalë.

3. Agjencia, kërkon nga likuidatori rishikimin e listëpagesës në bazë të aktit për ndarjen e trashëgimisë sipas ligjeve në fuqi.

4. Pas rishikimit nga likuidatori, Agjencia i dërgon bankës agjente listëpagesën e përditësuar e cila kryen veprimet për kompensimin sipas rasteve të përcaktuara në këtë aneks.

Dh. Pagesa e kompensimit për depozituesit tregtarë ose shoqëritë tregtare

1. Pagesa e kompensimit për depozituesit tregtarë dhe shoqëritë tregtare kryhet nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve vijues:

a) Ekstraktit origjinal nga Qendra Kombëtare e Biznesit të tregtarit/shoqërisë tregtare, i cili mban datë jo më të hershme se 10 ditë nga paraqitja për përfitimin e kompensimit. Emri i administratorit që është paraqitur për të përfituar shumën e kompensimit duhet të jetë në ekstraktin e QKB-së.

b) Certifikata e regjistrimit të tregtarit/shoqërisë tregtare në organin tatimor, ose kopje e noterizuar e saj, jo më herët se 10 ditë nga paraqitja për përfitimin e kompensimit;

c) Dokument identifikimi (ID/pasaportë) të administratorit të subjektit tregtar.

2. Pagesa e kompensimit bëhet nëpërmjet transfertës në një llogari bankare, në lek, në emër të depozituesit tregtar ose shoqërisë tregtare, në njërën nga bankat, që operojnë në Shqipëri, sipas informacionit që jepet nga administratori i subjektit tregtar.

3. Në rastin kur tregtari ose shoqëria tregtare përfaqësohet nga një person i autorizuar, përveç dokumenteve të përcaktuara në shkronjën “Dh”, pika 1 të këtij aneksi, duhet të paraqitet edhe

prokura origjinale e posaçme për pagesën e kompensimit. Prokura duhet të lëshohet nga përfaqësuesi i subjektit, emri i të cilit duhet të jetë i përfshirë në ekstraktin e QKB-së. Prokura duhet të përmbajë të dhënat e subjektit, të cilat duhet të përputhen me të dhënat e listëpagesës, si dhe të dhënat e personit të autorizuar, sipas dokumentit të identifikimit. Në prokurë duhet përcaktohet detyrimisht numri i llogarisë bankare në lekë, në emër të tregtarit ose shoqërisë tregtare, si dhe emri i saktë i bankës që operon në Shqipëri, në të cilën do të transferohet shuma e kompensimit.

* Banka agjente mund të kërkojë çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm, sipas rastit dhe në përputhje me ligjet në fuqi.

ANEKSI 4

KRITERET E KUALIFIKIMIT DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË BANKAVE AGJENTE DHE SUBJEKTEVE MBËSHTETËSE

(Ndryshuar me me Vendimin nr. 2680, datë 20.6.2024)

4.1 Kriteret e kualifikimit të bankave agjente

Bankat agjente kualifikohen, pasi të kenë përmbushur kriteret e mëposhtme:

1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes të bankave agjente

a) Banka nuk ka masa mbikëqyrëse të vendosura nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për bankat”, të ligjit “Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme” dhe të kuadrit rregullativ mbikëqyrës të nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tyre, në momentin e paraqitjes së dokumentacionit;

b) Profili i përgjithshëm i rrezikut të bankës është vlerësuar 1–3 sipas Bankës së Shqipërisë.

2. Kriteret teknike të vlerësimit të bankave agjente

Pikët:

Numri i degëve dhe i agjencive, si dhe shpërndarja e detajuar	
a) gjeografike, përfshirë postet përkatëse të punës arkë, shërbim klienti dhe rrjeti i ATM	25%
b) Aftësia për furnizimin dhe kapaciteti ditor i përpunimit të parasë në dorë (CASH), sipas secilës degë	10%
c) Aftësitë teknike të bankës agjente për të automatizuar proceset e brendshme për të përshpejtuar pagesat për kompensim	20%
ç) Koha mesatare (në minuta) për 1 transaksion në arkë	5%
d) Koha mesatare (në minuta) për 1 transaksion transfertë	5%
dh) Koha mesatare (në minuta) për hapjen e një llogarie të re	5%
e) Numri i operatorëve dhe kapaciteti përpunues i <i>call center</i>	5%
ë) Aftësia e bankës agjente për të ofruar mjete alternative pagese në rast kompensimi	5%
f) Poste pune të dedikuara për kompensim (sipas degëve) në dispozicion	10%
g) Poste pune shtesë për kompensim, arkë ose shërbim klienti	5%
gj) Mundësia për ofruar orë pune shtesë për kompensim, arkë ose shërbim klienti	5%

Total (Propozimi teknik) 100%

Minimumi i pikëve të propozimit teknik për t’u përfshirë në listën paraprake është 60%.

Fituese përzgjidhet banka agjente, e cila është vlerësuar me maksimumin e përqindjes për propozimin teknik dhe ka paraqitur ofertën ekonomike falas ose me çmimin më të ulët. Në rastin kur dy banka agjente janë vlerësuar me përqindje të njëjta më të larta të propozimit teknik, fituese do të përzgjidhet banka agjente e cila ka paraqitur ofertën ekonomike falas ose me çmimin më të ulët. Oferta ekonomike paraqitet në vlerë në lekë.

* Bankat agjente duhet të dorëzojnë dokumente origjinale, ose të noterizuara, të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së procedurës.

4.2 Kriteret e kualifikimit të subjekteve mbështetëse

Subjektet mbështetëse kualifikohen, pasi të kenë përmbushur kriteret e mëposhtme:

1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes të subjekteve mbështetëse:

- a) subjekti është i regjistruar në regjistrin tregtar dhe ka objektin e aktivitetit të kërkuar nga Agjencia;
- b) subjekti nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi (statusi aktiv);
- c) personi (personat) që veprojnë si administrator/aksionar/ortak të subjektit mbështetës, nuk është i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për vepër penale;
- ç) subjekti ka shlyer detyrimet në lidhje me taksat dhe tatimet;
- d) subjekti ka shlyer detyrimet në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore;
- dh) subjekti nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Kriteret teknike të përzgjedhjes të subjekteve mbështetëse:

- a) kontrata të ngjashme me objektin e kontratës të kërkuar nga Agjencia;
- b) licenca profesionale të nevojshme për zbatimin e objektit të kontratës të kërkuar nga Agjencia;
- c) kualifikime teknike dhe profesionale të stafit përgjegjës për përmbushjen e objektit të kontratës të kërkuar nga Agjencia;
- ç) personeli i nevojshëm për të zbatuar kontratën;
- d) dëshmi të mjeteve, pajisjeve teknike të nevojshme për të përmbushur kontratën, siç kërkohet nga Agjencia.

3. Kriteret financiare të përzgjedhjes të subjekteve mbështetës:

- a) kopje të certifikuara të bilanceve të një ose më shumë viteve, të paraqitura nga autoritetet përkatëse dhe raporteve të auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi;
- b) kopje të deklarave të xhiros vjetore.

* Subjektet duhet të dorëzojnë dokumente origjinale, ose të noterizuara, të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së procedurës.

4.3 Procedura e vlerësimit të bankave agjente dhe subjekteve mbështetëse

A. Vlerësimi për kriteret e përgjithshme dhe teknike

1. Anëtarët e komisionit/njesisë të vlerësimit deklarojnë konfliktin e interesit dhe përmbushin gjatë gjithë procedurës detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit.

2. Komisioni/njësia mban procesverbale dhe dokumentacion për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes, të cilat të përfshijnë, informacion mbi kërkesat për pjesëmarrje dhe ofertat e paraqitura, kontratat e nënshkruara dhe zbatimin e tyre.

3. Zarfet për pjesëmarrje në procedurën e kualifikimit pranohen dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit/njesisë në një ditë të vetme, pas përfundimit të afatit të përcaktuar për dorëzimin e tyre.

4. Zarfet të dorëzuara në komision/njësi përtej afatit të pranimit të tyre, nuk pranohen dhe i kthehen bankës/subjektit përkatës.

5. Nëse komisioni/njësia vëren se banka/subjekti ka mangësi në dokumentacion ata vendosin njoftimin e saj/tij dhe afatin për plotësimin e mangësive. Njoftimi i bankës/subjektit kryhet nga anëtari i autorizuar i komisionit/njesisë. Procesi i vlerësimit pezullohet deri në plotësimin e dokumentacioneve sipas njoftimit të komisionit/njesisë.

6. Komisioni/njësia vlerëson dokumentet e dorëzuara nga banka/subjekti, për përputhshmërinë e këtij dokumentacioni me kërkesat për kualifikim.

7. Si rregull, afati i shqyrtimit të dokumenteve përcaktohet nga komisioni/njësia. Ky afat mund të shtyhet sipas vendimit të komisionit/njesisë duke njoftuar Këshillin Drejtues të Agjencisë/drejtorin e përgjithshëm.

8. Banka/subjekti që nuk i plotësojnë kriteret, skualifikohen dhe njoftohen për këtë skualifikim brenda shtatë ditësh nga marrja e vendimit.

B. Skualifikimi

1. Agjencia skualifikon çdo bankë/subjekt, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese.

2. Agjencia përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e përzgjedhjes çdo bankë/subjekt, kur ka të dhëna se janë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;
- b) korrupsion;
- c) mashtrim;
- ç) pastrim parash;
- d) falsifikim.

3. Agjencia mund t'i kërkojë çdo banke/subjekti, të paraqesin dokumente dhe, kur ka dyshime, mund t'u drejtohet organeve kompetente për të marrë informacionin e nevojshëm për integritetin dhe gjendjen financiare të subjekteve në fjalë.

4. Vendimi për skualifikimin mund të merret nga Agjencia edhe në rast se:

a) banka/subjekti (ose stafi i tyre) shkelin ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi;

b) ka mospërputhje së bankës/subjektit me kriteret dhe kërkesat e Agjencisë të evidentuar gjatë verifikimit dhe raportimit;

c) banka/subjekti nuk ka përmbushur në mënyrë të kënaqshme kontratat e mëparshme me Agjencinë.

5. Vendimi për skualifikimin e bankës/subjektit merret nga Këshilli Drejtues i Agjencisë/drejtori i përgjithshëm, sipas propozimit të komisionit/njesisë të vlerësimit. Njoftimi për këtë i dërgohet bankës/subjektit jo më vonë se 7 ditë pune nga data e marrjes të vendimit përkatës.